

Komuna e Graçanicës: problemet kryesore dhe trendët buxhetor

Hyrje

1. Komuna e Graçanicës është themeluar më 2010, pas zgjedhjeve lokale të 2009. Si njësi e re komunale, Graçanica është formuar duke i shkëputur territor Komunës së Prishtinës, Lipjanit dhe Fushë Kosovës.
2. Graçanica përbëhet nga 16 zona kadastrale, me një sipërfaqe të përgjithshme prej 131,25 km². Në bazë të rezultateve nga regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, në këtë komunë jetojnë 10.675 banorë.¹ Shumica e banorëve janë të etnitetit serb. Vendbanimet (fshatrat) me popullatë më të madhe shqiptare janë Kishnica dhe Shushica.
3. Kryetar i Komunës së Graçanicës është Bojan Stojanović, anëtar i Partia e Pavarur Liberale (SLS), parti kjo që ka fituar mbi 60% të votave në zgjedhjet e mbajtura në nëntor 2009. Kuvendi Komunal i Graçanicës përbëhet prej 19 këshilltarëve komunal, 12 prej të cilëve vijnë nga SLS. Subjekti i dytë me i madh i përfaqësuar në Kuvendin e Graçanicës është Lëvizja Serbe për Rezistencë me dy këshilltarë, Lëvizja “Vidovdan” me dy këshilltarë, dhenga një përfaqësues kanë Partia Demokratike Serbe për Kosovën dhe Metohinë Partia Serbe për Kosovën dhe Metohinë dhe Lidhja Demokratike e Dardanisë. Përfaqësuesi i LDD është njëherit edhe nënkryetar i Komunës.
4. Të dhënat e UNDP-së (“Mozaiku i Kosovës 2012), tregojnë se 55% e qytetarëve të Komunës së Graçanicës janë të kënaqur me punën e kryetarit (mesatarja në nivel vendit është 69%), kurse 58% janë shprehur të kënaqur me punën e administratës komunale, përqindje kjo më e ulët se mesatarja në komunat e tjera të Kosovës që ka dal në 64%.²

¹ Agjencia e Statistikave të Kosovës. Rezultatet përfundimtare për Regjistrimin e Popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave - 2011. Burimi: http://esk.rks.gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore_ALB.pdf

² Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim – UNDP. “Mozaiku i Kosovës”. 2012. Fq 54. Burimi: http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Albanian_216825.pdf

Problemet kryesore në Komunën e Graçanicës

- 1. Reduktimet e ujit të pijes.** Në tri vitet e fundit, Komuna e Graçanicë përballet me reduktime të gjata të ujit të pijes, të cilat gjatë verës në zonën e qendrës së Graçanicës shkojnë deri në 10 orë në ditë. Kjo gjendje është e njëjtë edhe në fshatrat e kësaj komune, por për dallim nga zona urbane, fshatrat kanë hapur puse të ujit të cilat kanë ndikuar në zbutjen e gjendjes nga mungesa e ujit të pijes. Nga hulumtimi i UNDP-së, furnizimi i ujit nga ujësjellësi publik është problem i madh në komunën e Graçanicës. Një përqindje shumë e vogël (11%) e familjeve të lidhura me ujësjellësin publik pohojnë se kanë furnizim të pakufizuar me ujë, ndërsa, 24% raportuan se kanë pasur ndërprerje të furnizimit me ujë për 1 deri në 4 orë në ditë, 36% kanë mungesë të ujit për 5 deri në 10 orë në ditë, kurse 29% kanë ndërprerje të furnizimit të ujit më të gjata se 11 orë në ditë.³
- 2. Mungesa e objektit të ri të shkollës fillore në Kishnicë.** Gjendja në objektin e shkollës fillore “Ditët e Minatorit” në Kishnicë është e keqe. Objekti ekzistues është i vjetruar, dyert dhe dritaret janë të thyera, Shkolla akoma ngrohjen e siguron nga stufat si dhe dyshemeja është nga druri dhe mirëmbahet me mazut i cili konsiderohet i papërshtatshëm për mbarëvajtjen e mësimin. Në mungesë të pronës komunale, Komuna nuk ka arritur të gjejë një lokacion të përshtatshëm për ndërtimin e shkollës së re. Prona ekzistuese në Kishnicë ku është shkolla llogaritet të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP).
- 3. Rrugët e dëmtuara dhe mos mirëmbajtja e tyre.** Janë disa rrugë në Komunën e Graçanicës të cilat kërkojnë riparim të shpejtë. Kësisoj është rruga kryesore që të shpie në fshatin Kishnicë. Pastaj për në fshatin Shushicë si dhe për në fshatin Cagllavicë. Këto rrugë janë asfaltuar në vitet ‘80-ta dhe nuk janë riparuar asnjëherë. Në hulumtimin e opinionit të qytetarëve realizuar nga organizata DEMI/USAID rezulton se 47% e qytetarëve në këtë komunë janë të kënaqur me cilësinë e rrugëve në vendbanimet e tyre.⁴
- 4. Qenët endacak.** Qenët endacak paraqesin shqetësim për banorët e Komunës së Graçanicës. Prindërit detyrohen t’i përcjellin fëmijët e tyre për në shkollë nga frika e vërsuljes së qeneve endacak.

³ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim – UNDP. “Mozaiku i Kosovës”. 2012. Fq 52. Burimi: http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Alb_216825.pdf

⁴ Programi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim (USAID). Raporti i anketimit mbi kënaqshme rinë e qytetarëve me shërbimet komunale. Fq 26. Burimi: http://www.demi-ks.org/repository/docs/Citizen_Satisfaction_Report-Shqip.pdf

Komuna nuk ka dal me ndonjë plan për kastrimin dhe sterilizimin e qenve që besohet do të ndikonte në zvogëlimin dhe mënjanimin gradual të këtij problemi.

- 5. Zgjerimi i ndriçimit publik edhe në disa vendbanime.** Në zonën e Çagllavicës e cila ka rreth 30% të popullsisë së përgjithshme të Graçanicës nuk ka ndriçim publik gjatë orëve të natës. Pjesërisht ndriçimi ekziston në rrugën kryesore që të shpie te “Qendra Mediale” në këtë lokalitet. Në hapësirën e vogël që ekziston ndriçimi publik kapaciteti i saj është tejet i vogël. Pa ndriçim ekzistojnë edhe rrugët kryesore që të shpijnë në Kishnice, Shushicë, Radevë dhe Gushtericë e ulet.

Gjërat pozitive të cilat duhet mirëmbajtur dhe ruajtur

- 1. Mirëmbajtja e lumit.** Qytetarët në Graçanicë kanë kërkuar nga Komuna që të ruajnë shtratin e lumit “Graçanka” që përshkon qytetin nga hedhjet e mbeturinave ne te dhe nga uzurpimi i hapësirës përreth tij. Njeherazi kërkohet që të zgjerohet edhe në jug me rregullimin e shtratit të lumit dhe ndriçimin përskaaj tij.
- 2. Tokat bujqësore.** Njëra nga gjërat që duhet ruajtur në Graçanicë janë edhe tokat e shumta bujqësore, veçmas përgjatë magjistrales me Prishtinën. Krahas disa vendbanimeve tjera në Kosovë, edhe Graçanica ka cilësi të mirë të tokave bujqësore që u mundëson banoreve rendimente te mira për shume të mbjella. Këto toka bujqësore përgjithësisht nuk ruhen dhe iu janë ekspozuar ndërtimeve të ndryshme të vrazhda të cilat e pakësojnë dhe e dëmtojnë tokën bujqësore.


Trendet Buxhetore në Komunën e Graçanicës

Në vitin 2013, Komuna e Graçanicës do t’i ketë 5.7 milion euro buxhet, ndërsa viti 2012 është viti kur kjo komunë ka shënuar buxhetin më të lartë me gjithsej 6.4 milion euro. Viti 2012, ka qenë edhe viti me të hyrat më të larta vetanake gjithsej 1.3 milion euro. Sa i përket të hyrave vetanake, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm⁵ ka gjetur se komuna: a) ka pasur planifikim të dobët të hyrave; b) borxhi ndaj komunës arrin në 1.2

⁵ ZAP, Raporti i Auditimit mbi Pasqyrat Financiare të Komunës së Graçanicës për Vitin e Mbyllur me 31 Dhjetor 2012, 07 Gusht 2013 http://oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KGR_2012_Shqip_256112.pdf

milion euro; c) mungesë të dokumentacionit dhe bazës së kalkulimit të tarifave me rastin e dhënies së lejes për ndërtimet e reja.


Figura 1. Buxheti i Komunës së Graçanicës 2013



Burimi: <http://www.institutigap.org/spendings/?gracanice/2012#/~/~gracanice>

Në bazë të grafikorit të mëposhtëm rreth trendeve të ndarjeve buxhetore shohim se kjo komunë përveç që ka pasur një trend të ndryshueshëm të shpenzimeve kapitale gjithashtu është njëra ndër komunat e rralla që shpenzimet kapitale i ka më të mëdha se kategorinë e pagave dhe mëditjeve. Në anën tjetër, sipas ZAP-it kjo komunë duhet të marrë masa tek kategoria e mallrave dhe shërbimeve të mos nënshkruhen kontrata pa i siguruar fondet e mjaftueshme.

Figura 2. Trendet e ndarjeve buxhetore 2010-2013



Në bazë të tabelës së mëposhtme shohim se Komuna e Graçanicës planifikon që të ketë një rritje graduale të të hyrave vetanake dhe grantit qeveritar. Kjo rritje e të hyrave pritet të reflektohet në rritjen e shpenzimeve në të gjitha kategoritë.

Tabela 1. Planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve 2014-2016

Të hyrat	2014	2015	2016
Të hyrat totale	5,557,376	5,785,621	5,998,124
Të hyrat vetanake	1,455,677	1,499,347	1,529,334
Grantet	4,101,699	4,286,274	4,468,790
Shpenzimet	5,708,467	5,936,805	6,174,277
Pagat dhe Mëditjet	2,406,732	2,503,002	2,603,123
Mallrat dhe Shërbimet	1,073,955	1,116,913	1,161,589
Shërbimet Komunale			
Subvencionet dhe Transferet	132,000	137,280	142,771
Shpenzimet Kapitale	2,095,780	2,179,610	2,266,794

Metodologjia e hartimit të raportit

Instituti GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulamtuese (BIRN) janë aktiv në fushën e qeverisjes lokale dhe monitorimin e fushatave para zgjedhore që nga zgjedhjet lokale të 2007. Përgjatë këtyre viteve, në bazë të punës hulamtuese dhe analitike, janë grumbulluar informata të shumta për nivelin e qeverisjes lokale, problemet kryesore dhe trendët buxhetore të komunave.

Identifikimi i problemeve kryesore në Komunën e Graçanicës është bërë përmes intervistave dhe fokus grupeve me njerëzit aktiv të komunës, si gazetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile, etj. Të gjeturat e GAP dhe BIRN janë krahasuar edhe me të dhënat e hulamtive më të mëdha që janë bërë viteve të fundit në nivel lokal, ai i UNDP (Mozaiku i Kosovës 2012-shërbimet publike dhe qeverisja lokale në fokus) dhe DEMI/USAID (Raport i Anketimit mbi Kënaqshmërinë e Qytetarëve me Shërbimet Komunale, 2012).



Instituti GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institute të ngjashme në shtetet perëndimore. GAP u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.